

Mbi një studim të vjetër me vlerë ballkanologjike

Mr. Agim Spahiu

20 dhjetor 2006

Përmbledhje

Në këtë shkrim prezantohet një studim i hershëm gjuhësor mbi ballkanizmat të autorit P.PAPAHAGI me titull: **Parallele Ausdrücke und Redensarten in Rumänischen, Albanesischen, Neugriechische und Bulgarischen**, botuar më 1908 në Lajpzig.

Ditë më parë, duke shfletuar disa faqe interneti më ra në sy një shkrim ose më mirë të themi një botim shumë interesant për të cilin nuk kisha dëgjuar dhe lexuar më parë: fjala është për një studim të moçëm që i takon fushës së gjuhësisë ballkanike. Studimi është titulluar **Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanesischen, Neugriechischen und Bulgarischen** (shq. *Shprehjet / thëniet dhe idiomat gjuhësore paralele në rumanishte, shqipe, graqishte të re dhe bullgarishte*) dhe është përgatitur e mbrojtur si tezë e disertacionit të doktoratës nga autori **Pericle Nikola PAPAHAGI**, (një arumun, i lindur më 1870 në Avela të Turqisë së atëhershme) qysh më 1908 në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Lajpcigut. (Inaugural - Dissertation zur Erlangung der Doktorwürde der Philosophischen Fakultät der Universität Leipzig).

38. c) Das Auge wurde mir zu Kupfer = Das Auge ging mir über. Ar. Oculi bëcëre ni si feaþirë. Alb. m u-be sÿri bakër. Hahn, Gl. 11.

39. d) Das Auge erschrickt (zuckt) ihm nicht = er kennt keine Furcht. Ar. Nu-I se-aspare oculul. Alb. Nuke i utremp (zitteri) sÿri, Skenderbeg, 5, 1. Δεν σκιάζεται τὸ μάτι του. Blg. Ne mu puka (oder trepka) okoto.

40. e) Er hat das Auge zu gehen = er beabsichtigt

πυγῶνι „Kinn“ zu agr. πῶγων „Bart“. Bulg. brada „Kinn“ und „Bart“.

47. Befreien. Bedeutung: gebären, entbunden werden. Beispiel: Die Wöchnerin ist entbunden worden. Alb. Lehona u-dalir. Ngr. Ἡ λεχῶνα λευτερώθηκε.

48. Begegnung. *Wendung: Gute Begegnung = Auf Wiedersehen! Dr. bun intilniq! Ar. Andamuse bunã. Ngr. Καλὴν ἀντάμωσι! [Bulg. Dobra srešta! (Gute Begegnung!]

Fig. 1: Pamje nga botimi i autorit P. N. PAPAHAGI, 1908

Ky studim është hedhur në një faqe të internetit¹. Është i fotokopjuar (dy faqe në një) dhe ka 170 faqe tekst me një format të vogël (diku rreth 13. 5 x 8. 5 cm.) Ishte botuar në shtypshkronjën Johann Ambrosius Barth, po ashtu, në Lajpcig më 1908. Mirëpo teksti në internet ka dalë me një gabim teknik, ngase çdo e dyta faqe është e pafotokopjuar, d.m.th. është kaluar, po e zëmë, nga faqja 114/115 në 118/119 e kështu me radhë. Kjo

¹<http://www.albanianorthodox.com/tekste/albanologji/papahagi.pdf>.

do të thotë se teksti, për fat të keq, është i përgjysmuar. Mirëpo, sido që të jetë, pjesa ekzistuese lexohet relativisht qartë dhe mund t'i hyjë në punë çdo studiuesi të kësaj disipline gjuhësore.

Për ta hartuar këtë vepër, P. Papahagi kishte shfrytëzuar disa burime shkencore nga veprat studimore dhe leksikografike të asaj kohe, të cilat janë shënuar në parathënie e, në mënyrë të veçantë, në fund të tekstit. Sa për gjuhën shqipe kishte shfrytëzuar disa fjalorë të gjuhës së atëhershme shqipe, siç janë: *Studime shqiptare (Albanesische Studien, Jena 1854)* të Hahn-it, pastaj *Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe (Etimologjische Wörterbuch der albanesischen Sprache, Straßburg, 1891)* dhe *Gramatikën e shkurtër të shqipes (Kurzgefaßte albanesische Grammatik, Leipzig 1888)* të Gustav Majerit, si dhe *Tekstet shqiptare me fjalor (Albanesische Texte mit Glossar, Leipzig, 1895)* të H. Pederseinit. Ndërsa për gjuhët sllave kishte shfrytëzuar po ashtu edhe studimin e njohur të sllavistit dhe ballkanologut të njohur F. Mikloshiq *Die Slavischen Elemente im Rumunischen*, (Vjen, 1861), pastaj ligjëratat, udhëzimet dhe studimet e G. Wajgandit (Vollmöllers Jahrebericht IV), të cilin e kishte pasur edhe profesor në vitin 1905 në Lajpcig etj. Nga kjo shihet se ky autor në atë kohë kishte një përgatitje të duhur shkencore jo vetëm nga aspekti gjuhësor për studimin e kësaj çështjeje, por edhe më gjerë, siç është aspekti historik. Por ishte edhe mjaft modest kur thoshte që në parathënie se *"Unë nuk jam i pari që merrem me këtë detyrë, ngase që prej sa kohësh me këtë çështje janë marrë shumë dijetarë të njohur me mendjemprehtësi e zell, të cilët, me gjithë mjetet e pamjaftueshme ndihmëse që kanë pasur ata, rezultatet e tyre konsiderohen të kënaqshme. Prandaj unë po e shkel tani atë rrugë që e kanë shkuar këta dijetarë shumë kohë para meje"*². Ai që në fillim bën një paralelizëm duke thënë se *"ajo çka vlen për rumunët, vlen pak a shumë edhe për të gjithë popujt e Ballkanit, sepse edhe historinë e kanë pasur pak a shumë të ngjashme"*³.

Në këtë vepër Papahagi ka përfshirë pothuajse të gjitha shkallët e njësive gjuhësore sintaksore, që, sipas tij, përbëjnë paralelizma në gjuhët e përmendura ballkanike: fillon nga fjala e thjeshtë, togu e togfjalëshi e deri te fjalia e përbërë a periudha. Me fjalë të tjera, në studim përfshihen jo vetëm shprehjet/thëniet që përdoren në jetën e përditshme pa ndonjë ngjyrim të theksuar emocional e deri te ato me ndërtim të qëndrueshme e me kuptim figurativ, siç janë frazeologjizmat, proverbat e shprehjet e ndryshme popullore.

Në këtë vepër, herë pas here autori ka marrë shembuj edhe nga gjuhët: serbe, turke, madje edhe ruse. Ja disa shembuj që, sipas P. Papahagit, përbëjnë paralelizma në këto gjuhë:

1. **Veštro punen tende!**

Caută - țî de treabă! (rum.)

Κοίταξε τή δουλειά! (greq. re);

Gledaj si rabota! (bullg.);

2. **Nuke i utremp süri, Skenderbeg**

²f. 114.

³Po aty, f. 114.

- Δέν σχιάζεται τό μάτι του (greq. re)
 Nul' se - aspere ic'ul (rum)
 Ne mu puka okota (bullg.)
3. **S - mε ndzεn mεndja**
 Nu n - u ncape mintea (rum.)
 Δέν τό λωρετ ό νούς μον (greq. re)
 Ne mi go pobira umъt (bullg.)
4. **Mbuši dūzet vjetš**
 A implinit patruzeci de ani (rum.)
 Наръlnи (навърši) cetireset godini (bullg.)
5. **tε u -mbuš koka?**
 Ți si umplú caplu (rum.)
 γιόμιζε τό κεφάλι τον (grq. re)
 Наръlnи li ti se glavata?⁴ (bullg.)
6. **hangrεn škop**
 Mica fuște, lemn, škop (rum.)
 jade boj (dъrvo) (bullg.)
 agaz jemek (tuq.)
 τρώγω ξύλο ⁵(grq. re)
7. **Mε hangri veš (t)**
 Mi - a mincat erecbile (rum.)
 Μον έφαφε ταύτιά (grq. re)
 izede mi ušite⁶ (bullg.)
8. **Mi (rε) se tε gεta!**
 Bine te-am gasit!
 Καλος ζέ βρήχα! (grq. re);
 Dobre našel!⁷ (bullg.)

⁴f. 126

⁵f. 127.

⁶f. 127.

⁷f. 135.

9. **ndzier špirtine**

Scot sufletul (rum.)

Βγάζω τήν φνχή (grq. re)

Izvadicha mi dušata (bullg.)

10. **Me ðemp zemra**

Ma doare inima (rum.)

πονει ή χαρδιά μου (greq. re)

boli me srce⁸(bullg.)

11. **S - ka ñerzi**

Δέν χει άρωλιά (greq. re)

N'are omenie/o - are uminitate. (rum.)

Ne e covēština⁹ (bullg.)

12. **Me špirt nde goje** (= dhëmb, - A. S.)

μέ ότό ότόμα (greq. re)

Cu sufitlu la gura/ cu sufletul la gura (rum.)

Dušata mu e v zbité¹⁰

13. **mbeti pa goje**

Armase fara gura. (rum.)

Εμεινε χωρίς ζτόμα. (greq. re)

Ostana bez usta.¹¹ (bullg.)

14. **mař veř**

Láu di ureacle. (rum)

Πάίρω άλό ταύτί ¹² (greq. re)

15. **Hola/para te barda per dite te zes**

Ασπροι παράδες για μαύρες μέρες (greq. re)

Bani albi pentru zile negre. (rum.)

Beli pari za cerni dni.¹³ (bullg.)

⁸f. 139.

⁹f. 146.

¹⁰f. 147.

¹¹f. 147.

¹²f. 150.

¹³f. 155.

16. **Atié gen edé kumështε zogu** (= qumësht, - A. S.)

Εχει χού πουλιού τό γάλα βρίςχης (greq. re)

tamo šte nameriš i ot pticka mleko. (bullg.)

Aclo ș - lapte di puilu afli (rum.)

ticje mleko. (serb.)

птичье молоко (rus.) etj.

Sido që të jetë, ky studim ka një vlerë të madhe historike, ngase dëshmon shumë qartë se këtu e 100 vjet më parë paska pasur studiues që janë marrë me hulumtimin shkencor të **lidhjeve gjuhësore ballkanike**. Ky studim gjuhësor zë një vend meritë në historinë e trajtimit shkencor të problemeve të ballkanologjisë, për vetë faktin se është botuar edhe para veprës së K. Sandfeld-it (1930).

Vepra studimore e P. N. Papahagi-t **Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanesischen, Neugriechischen und Bulgarischen** sot ka mundësi të jetë edhe një pikë reference e studiuesve të rinj të fushës së ballkanologjisë. Ata mund ta vështrojnë atë gjerësisht nga shumë anë e aspekte.